

Ky Akt themelimi i shoqërisë “Asi2Construction” sh.p.k., është përshtatur sipas kërkesave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, gjithashtu mbështetet në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar) dhe në ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

## **AKT THEMELIMI**

### **i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar**

### **“Asi2Construction” sh.p.k**

#### **KREU I**

#### **THEMELIMI, FORMA, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

##### **Neni 1**

##### **Forma**

Shoqëria “Asi2Construction” sh.p.k është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), me ortak të vetëm themelues z. Mentor Çokaj.

##### **Neni 2**

##### **Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është “Asi2Construction” sh.p.k.

##### **Neni 3**

##### **Selia dhe ushtrimi i veprimtarisë**

Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga Don Bosko, Vizion Plus, Tiranë, Shqipëri.

Me Vendim të Ortakut të vetëm, Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë seli; të hapë adresa të tjera të aktivitetit brenda territorit të Shqipërisë; zyra përfaqësie e degë të Shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; si dhe ka të drejtë të themelojë, apo të jetë bashkëthemeluese, në subjekte të reja juridike, apo të blejë kuota/aksione të subjekteve juridik ekzistues.

##### **Neni 4**

##### **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj.

Objekti i aktivitetit është i përgjithshëm.

Ai përfshin veprimtaritë e mëposhtme, por nuk kufizohet në to, si:

I. NË PROJEKTIM:

1. PROJEKTUES URBANIST:

- a) Master plane - studime e plane rajonale urbanistike.
- b) Plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara - qytete.
- c) Studime pjesore urbanistike.

2. PROJEKTUES ARKITEKT:

- a) Objekte civile - industriale, turistike deri në 5 kate.
- b) Objekte civile - industriale, turistike mbi 5 kate.
- c) Objekte sportive.
- d) Projektim interiere.
- e) Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR:

- a) Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- b) Objekte civile - industriale – turistike mbi 5 kate - objekte me skelet metalik.
- c) Objekte me shkallë të lartë vështirësie, beton arme - metalike - troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

4. PROJEKTUES INSTALATOR:

- a) Instalime hidrosanitare.
- b) Instalime termoteknike - ventilimi – kondicionimi.
- c) Linja e rrjeta elektrike - telefonike - radiotelefoni - citofoni - sistem alarmi - televiziv etj., për objekte civile, industriale, turistike.
- d) Sisteme komplekse të telekomunikacionit.
- e) Sisteme të furnizimit me gaz.

5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE:

- a) Diga - galeri - tunele hidraulike.
- b) Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.
- c) Ujësjiellës kanalizime urbane - rurale.
- d) Vepra ujitëse - kullimi - impiante vaditëse - diga deri në 10 m - damba.
- e) Vepra të trajtimit të ujit.
- f) Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri - porte - pontile,
- g) Vepra naftësjellëse - gazsjellëse - vajsjellëse etj.

6. PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA:

- a) Rrugë auto kategoria V dhe VI.
- b) Projektim rruge kategoria III, II, dhe I.
- c) Shtresa rrugore e sistemim - asfaltime.
- d) Autostrada - pista - aeroporte - heliporte.
- e) Hekurudha, degëzime - hekururdhore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI:

- a) Ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m.
- b) Ura dhe vepra arti mbi 10 m- estakada.
- c) Ura metalike - të varura.
- d) Tunele rrugore - hekurudhore.

8. PROJEKTUES GJEODET:

- a) Bazamente gjeodezike për rivelime në të gjitha shkallët. B
- b) Projektim fotogrametrik - hartografik - topografik.

9. STUDIM GJEOLLOGO INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK:

- a) Studim/vlerësim gjeologjor inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri në 5 kate.
- b) Studim/vlerësim gjeologjor inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
- c) Studim/vlerësim gjeologjor inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/C, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
- d) Studim/vlerësim gjeologjor inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- e) Studime e projektme hidrogjeologjike

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË:

- a) Centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare).
- b) Centrale termike (primare, sekondare).
- c) Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike - diellore - ere etj.
- d) Nënstacione elektrike, primar, sekondar - linja të tensionit të lartë.
- e) Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

II. NE ZBATIM:

1. GËRMIMË DHEU ME PUNIME EVENTUALE MURATURE E BETONARME, PRISHJE DHE PUNIME NË TOKË TË GËRMUAR:

2. PRODHIM MATERIAL NDËRTIMI:

- a) Prodhim materiale inerte - gurë.
- b) Prodhim qeramike tulla - tjegulla - fajancë.
- c) Prodhim elementë betoni e betonarme të zakonshëm - paranderur - gurë dekorative.
- d) Prodhim material lidhës, gëqllere - allçi - çimento.
- e) Prodhim materiale me bazë bitumi - sintetike.

3. NDËRTIME CIVILE DHE EKONOMIKE:

- a) Ndërtime civile- industriale - turistike - bujqësore deri në 5 kate.
- b) Ndërtime civile - industriale - turistike - bujqësore mbi 5 kate - rikonstruksione.
- c) Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.

4. NDËRTIME RRUGORE:

- a) Ndërlim rruge Kategoria IV dhe V.
- b) Ndërtim rruge kategoria III dhe II-I.
- c) Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore.
- d) Ndërtim autostrade - pista - aeroporte - heliporte.

5. NDËRTIME HEKURUDHORE:
  - a) Punime hekurudhore.
  - b) Punime speciale të shinave dhe traversave.
  - c) Punime në sistemin elektrik dhe sinjalizimit.
6. NDËRTIM URA DHE VEPRA ARTI:
  - a) Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10m.
  - b) Ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m - eskatada - ura metalike të varura.
  - c) Ndërtim tunele rrugore - hekurudhore.
7. NDËRTIME DETARE:
  - a) Ndërtime portuale - bankina - basene – pontile.
  - b) Punime thellimi – drenimi.
8. NDËRTIME HIDRAULIKE DHE HIDROTEKNIKE:
  - a) Ndërtim ujësjellës - kanalizimi - kanale e impiante vaditje.
  - b) Punime mbrojtje të sistemit hidraulik - çimentime etj.
  - c) Ndërtim impiante të trajtimit të ujit.
  - d) Ndërtim vajsjellës - gazsjellës - naftësjellës.
  - e) Ndërtim diga - damba deri 10 m.
  - f) Ndërtim galeri - tunele.
  - g) Ndërtim diga të larta.
9. VEPRA TË VEÇANTA E PUNIME SPECIALE:
  - a) Sillose, kulla, kulla uji, etj, b/a - metalike.
  - b) Përforcime themeli e punime nëntokësore.
  - c) Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujrati.
  - d) Themele të veçanta.
  - e) Puse - çpime gjeologjike inxhinierike - çpime për ujë.
10. PUNIME RESTAURIMI
  - a) Restaurimi i ndërtesës monument kulture.
  - b) Punime restaurimi në vepra arkeologjike.
11. PUNIME KARPENTERIE
  - a) Druri
  - b) Metali
12. IMPIANTE TEKNOLOGJIKE DHE TË VEÇANTA
  - a) Instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensore, shkallë levizëse, transportues në pergjithësi) - mirëmbajtja e tyre.
  - b) Instalimi i impianteve termike - ventilimit - kondicionimit të ajrit - mirëmbajtja e tyre.
  - c) Instalimi i impiantëve higjenikë, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare - mirëmbajtja e tyre.
  - d) Instalimi i impiantëve pneumatikë, të sigurimit të kontrollit - mirëmbajtja e tyre.
  - e) Instalimi i materialeve prej druri - metalike - plastike - xhami etj.
  - f) Punime bojatisje - hidrizolimi - termoizolimi - akustike - kundër zjarrit.
  - g) Instalimi i impianteve nën presion - mirëmbajtja e tyre.

13. PUNIME MONTIMI NË IMPIANTET E PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

- a) Centrale hidra^likçprova me ngarkesë.
- b) Centrale termike prova me ngarkesë.
- c) Impiante për prodhimin e energjisë nga burime alternative,
- d) Instalime për n/stacionet - kabinat e transformatorëve - linjat e T.N e të mesëm.
- e) Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike të T.U linjave të telefonit, radiotelefoni, televizive, citofoni - mirëmbajtja e tyre.

14. PUNIME SHËRBIMI

- a) Punime në sipërfaqe të gjelbërta, parqe - pyllparqe.
- b) Pastrimi i sipërfaqeve urbane.
- c) Kryerja e punimeve në shërbesat funerale.
- d) Mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndriçimi dhe sinjalizimi urban.

15. PUNIME TOPOGJEODEZIKE

- a) Rivelimetopografike.
- b) Punime topogjeodezike në objektet inxhinierike.
- c) Punime speciale gjeodezike, rrjeta mbështetëse, qëndrueshmëri terrenesh.
- d) Punime fotogrametrike - hartografike.

III. TREGTARE

- a) Tregtimit me shumicë e pakice dhe import eksport të:  
mallra industriale, ushqimore, lënde të para, pjesë këmbimi për makina, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro-sanitare, hidraulike, kanceleri për zyra e shkolla, orendi shtëpiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtëpiake, pjesë këmbimi për automjete, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, produkte të detit, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente.
- b) Hoteleri turizem, bar - kafe e restorant.
- c) Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit.
- d) Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit.

IV. SHËRBIME

- a) Studime në nivel strategjik, manaxherial dhe operacional, analiza, vrojtme, sondazhe, kërkime, vlerësime;
- b) Konsulencë, shërbime administrative dhe manaxhim projektesh për subjekte fizikë dhe juridikë, publikë shtetërorë dhe privatë (shoqëri tregtare, apo OJF), vendas dhe të huaj;
- c) Organizimi dhe zhvillimi i kurseve të formimit profesional në fushën e sistemeve të informimit gjeografik (GIS), të gjeodezisë, hartografisë, remote-sensing, fotogrametrisë, etj., kryerje e trajnimeve të ndryshme të fushës.

**Neni 5**

## **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

## **KREU II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË (ZMADHIMI, ZVOGËLIMI, TRANSFERIMI)**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm themelues me kuota me vlerë të përgjithshme totale 100.000 lekë, që përbëjnë 100% të kuotave të zotërimit të kapitalit të shoqërisë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë.

#### **Neni 7**

#### **Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufizim, në çdo moment, një apo disa herë dhe vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm, mbi bazën e raportit të hartuar nga Eksperti Kontabël, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit të shoqërisë për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të ekspertit të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm, në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakut të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar nga ligji i shoqërive tregtare, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën nominale.

#### **Neni 8**

#### **Transferimi i kapitalit**

Vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm, kuotat e kapitalit të shoqërisë mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri (nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, dhurimit, dhe çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj).

Pjesët e kapitalit të shoqërisë janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

##### **Neni 9**

###### **Organi vendimmarres**

Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetëm miraton çdo ndryshim të statutit dhe akt themelimit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i Vetëm, brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori/ët. Ai mund të përfaqësohet edhe nga një person tjetër, nëpërmjet prokurës.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen, ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e mësipërme të paregjistruara në regjistrin e vendimeve, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

##### **Neni 10**

###### **Ndryshimet ne statut**

Ndryshimet në statut vendosen nga ortaku i vetëm.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë në regjistrin tregtar, duke aplikuar brenda 30 ditëve nga data e vendimit të ortakut të vetëm për ndryshimin e statutit.

##### **Neni 11**

###### **Administrimi**

Ortaku i vetëm themelues z. Mentor Çokaj , është njëkohësisht edhe Administrator i shoqërisë, banues në adresën: Rruga Don Bosko, Vizion Plus, Tiranë, Shqipëri dhe me këtë specimen nënshkrimi

Drejtues teknik i shoqërisë do te jete znj. Valentina Hoxha.

Në rast se gjatë veprimtarisë së shoqërisë do të vendoset ndryshe në lidhje me administrimin, detyrimisht Administratori i shoqërisë do të emërohet dhe shkarkohet vetëm me vendim të ortakut të vetëm. Ortaku i Vetëm vendos për sistemin e administrimit, përcakton numrin e administratorëve dhe kompetencat e tyre. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë. Administratori do të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë maksimale 5 vjeçare sipas ligjit.

Asambleja e Ortakut të vetëm, nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, mund të lejojë ortakët dhe administratorët e shoqërisë të mbajnë një pozicion drejtues, apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona me këtë autorizim të posaçëm, mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

## Neni 12

### Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një ortak i vetëm. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizik dhe juridik, publik dhe/ose privat, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakut të vetëm të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejtën të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qerasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë akt themelimi të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak (pas vendimit miratues të Asamblesë së Ortakut të vetëm), të nënshkruajë e të hartojë çdo dokument, e të kryejë në emër të shoqërisë çdo veprim përballë bankave shqiptare, apo të huaja në lidhje me çeljen, apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e shoqërisë, si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash në këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se, të tretët e dinin që akti i administratorit e kalon objektin e shoqërisë, apo kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.



Administratorit, ose ortakëve që nuk janë persona juridik, nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie, si dhe të bëhen dorëzanës, apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Përveç kompetencave të mësipërme, Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e ortakut të vetëm;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së ortakut të vetëm për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

### **Neni 13**

#### **Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje statuti, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku i vetëm ka të drejtë të ngrejë padi penale kundrejt administratorit.

Ortaku i vetëm ka të drejtë të ndjekë në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë përfshirë edhe dëmin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

### **Neni 14**

#### **Viti financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet më 31 dhjetor.

#### **Neni 15**

##### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç parashikohet edhe në ligj.

#### **Neni 16**

##### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur, ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ortaku i vetëm.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

#### **Neni 17**

##### **Bilanci kontabël vjetor**

Bilanci kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetëm, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre, por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke patur parasysh fondin e veçantë të tij.

#### **Neni 18**

##### **Të ardhurat**

Të ardhurat neto (dividendi) që mbetet pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal, apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakut të vetëm të shoqërisë.

#### **Neni 19**

##### **Shpërndarja e shoqërisë**

Shpërndarja, ose prishja e shoqërisë, mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut edhe para afatit për arsyen të cilën është krijuar, siç mund të jenë:

- a) Humbja e kapitalit, ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj;
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji nr.8901, datë 23.05.2002 për “Falimentimin” (i ndryshuar).

Në këtë rast, Ortaku i Vetëm merr vendimin me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të lëshuar prej tij: emrin e likuidatorit dhe emërtimin shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

## **Neni 20**

### **Bashkimi e ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t’i kalojë trashëgiminë e saj, një shoqërie ekzistuese, ose një shoqërie të re që ajo ka krijuar.

Ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadër të operacioneve të sipërpërmendura, përfiton pjesën e kapitalit themeltar nga shoqëria, ose shoqëritë përfituese.

Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen nëpërmjet shoqërive të formave të ndryshme. Bashkimi ose ndarja, sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj në shoqëritë përfituese në gjendjen që ndodhet kjo shoqëri në momentin e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi, ose ndarja, sjell njëkohësisht për ortakun e shoqërisë që zhduket, marrjen e cilësisë së ortakut në shoqërinë përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

## **Neni 21**

### **Emërimi i likuidatorit**

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që përcakton ligji përkatës, duke specifikuar dokumentet që duhen depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 22**

### **Veprimet e likuidatorit**

Likuidatori është i detyruar të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, duke zbatuar të gjitha detyrimet e tij sipas ligjit, si për realizimin e të drejtave ndaj subjekteve në të cilët shoqëria është kreditor, ashtu edhe për ekzekutimin e detyrimeve/debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë, apo personave fizik e juridik vendas, apo të huaj.

## **Neni 23**

### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin dhe dispozitat e legjislationit shqiptar në fuqi.

Përsa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar); ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.8901, datë 23.05.2002 për “Falimentimin” (i ndryshuar), si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 24

##### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin, apo interpretimin e statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim, për shqyrtimin e tyre do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### Neni 25

##### Dispozita përfundimtare

Ky Akt themelimi u redaktua në pesë kopje me përmbajtje e vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku Themelues i shoqërisë tregtare “Asi2Construction” sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin e firmën e tij origjinale (ndërsa vetëm nënshkrimin në çdo fletë).

ORTAKU I VETËM THEMELUES

MENTOR ÇOKAJ

Mentor Çokaj



Dt. 01/03/2022